


LIGJI VEPRON



PËR TË GJITHË
NJËLLOJ

POPULLI DHE DEMOKRACIA

VALDRIN (14), EGZON (14), ERZANA (13), BENITA (14), SUZANA (15), EDONA (14), ALBINA (13),

ELHAME (14), YLLZA (12)



E drejta e shkollimit, më e dashura për ne



Paqen dhe lirinë e gëzojmë në demokraci

Mëso më shumë për demokracinë, historikun e saj dhe rolin tonë në demokraci. Lexoni më poshtë

Ne gjithmonë e kemi ditur rëndësinë e demokracisë. Mirëpo, sot në „Demos-ti“ e kuptuam rëndësinë tonë në demokraci. Roli ynë është kyç në këtë formë të qeverisjes. E themi këtë, sepse vota jonë është rruga drejt suksesit dhe progresit të shtetit. Me anë të votës, ne i zgjedhim personat të cilët njihen si përfaqësuesit tanë dhe kanë për detyrë ta udhëheqin shtetin. Andaj, është e lehtë për t'u kuptuar se ne si popull udhëheqim në demokraci. Jemi të lirë dhe kemi të drejta. Kemi të drejtë të shkollohemi, të kemi identitet, të shprehemi lirshëm, të votojmë, etj. Përpos që kemi të drejta, ne jetojmë në bazë të elementeve të demokracisë. Këto elemente janë mburoja jonë, që të jetojmë një jetë sa më të mirë. Respekti, solidariteti, toleranca, paqja, dhe barazia, janë këto elementet tona jetësore. Edhe ne në shkollën tonë i respektojmë këto parime. Jemi të gjithë të barabartë dhe tregojmë respekt ndaj njëritjetrit. Tregohemi tolerantë, atëherë kur është nevoja. Kur njëri nga ne ka nevojë për ndihmën tonë, ne solidarizohemi dhe e ndihmojmë atë.


Ne mendojmë se barazia është elementi më i rëndësishëm. Kur një person i komunitetit romë, është i sëmurë dhe kërkon ndihmën e mjekut, mjeku duhet ta trajtojë atë në mënyrë të barabartë, si të gjithë të tjerët. Demokracia ka dy forma kryesore: demokracinë përfaqësuese dhe atë të drejtpërdrejtë. Ne kemi demo-

kraci përfaqësuese, sepse i zgjedhim përfaqësuesit, të cilët marrin vendime në emrin tonë. Kurse, shtetet që kanë demokraci të drejtpërdrejtë i marrin vendimet aty për aty.

Koha ka ndikuar edhe në demokraci dhe ajo e ka ndryshuar atë për të mirë. Në fillim, kur është paraqitur demokracia në Athinë, ajo ka qenë e mangët. Kjo sepse elementi i barazisë ka qenë më pak i theksuar ngase të drejtë vote kishin vetëm burrat e pasur. Sot jemi të gjithë të barabartë dhe kjo na bën të lumtur. Demokracia është e jona dhe ka nevojë për përkujdesjen tonë. Ne gjithmonë do të jemi të gatshëm të punojmë për demokracinë. Ashtu sikurse trupi që ka nevojë për ushqim, edhe ne kemi nevojë për elementet e demokracisë, në mënyrë që të jetojmë pa bregnga. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë.



Gazetarët e artikullit



Ligjet duhet të zbatohen dhe të respektohen



Bashkëpunimi është i nevojshëm në demokraci




Populli është ai që merr vendime në demokraci



Të gjithë e kemi të drejtën e votës




Votimi është një e drejtë e jonë, por edhe përgjegjësi



E ardhmja e shtetit është në duart tona

DETYRAT E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

ERISA (13), SHKËLQIM (14), ERINDA (13), ERMIR (14), MEDINA (14), MARIGONA (14), JAHIR (14),
SABRIJE (14), FIDAIJE (13)



Pushteti në Kosovë ndahet në atë mënyrë që secili institucion t'i ketë detyrat dhe pushtetin e vet

Nëse Kosova jonë demokratike, do të ishte trup i njeriut, ashtu si trupi ynë që ka katër gjymtyrë me rëndësi të madhe, ashtu edhe Kosova ka institucione, po aq të rëndësishme sa gjymtyrët e njeriut.

Ndarja e Pushtetit funksionon në një vend demokratik, siç është Kosova.



Demokracia na mundëson të kemi të drejtën t'i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues marrin vendime në emrin tonë, dhe i përfaqësojnë interesat tona në Kuvend. Kuvendi i Kosovës është institucioni më i lartë i shtetit, i cili ushtron Pushtetin Legjislativ. Aty miratohen ligjet, me anë të votave të deputetëve. Po ashtu, deputetët kanë të drejtë të propozojnë dhe të shfuqizojnë ligjet.

Pushtetin Ekzekutiv e ushtron Qeveria, udhëheqësin e së cilës e zgjedhin deputetët. Ky udhëheqës është

Kryeministri, i cili e menaxhon Qeverinë, në të cilën funksionojnë ministri të ndryshme.

Disa nga ministritë janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës, etj. Ligjet të cilët miratohen në Kuvend vlejnjë për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim. Ndërsa, me personat të cilët nuk i zbatojnë ligjet, merret Pushteti i Gjyqësorit. Kemi këto lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.

Të dashur lexues, kjo ishte ajo që ne mësuam në grupin tonë. Ashtu siç e krahasuam Kosovën me trupin e njeriut, ku rëndësia e të gjitha gjymtyrëve të trupit është e njëjtë, ashtu edhe rëndësia e institucioneve të Kosovës është e njëjtë. Por, edhe pse pushtetet e Kosovës janë të ndara, ato bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si të ishin një.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës

ZGJEDHJET I BËJMË NE

HAKIK (13), SIHANA (14), FATMIRE (14), SELVETE (14), FESTINA (13), ADISA (14), YLLËZA (13),


BLERTA (13)



Lexues të dashur, nga ne do të mësoni se si populli vendos për qeverisjen e duhur të vendit

Ne si popull i kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona. Në kohët e mëhershme, këto të drejta nuk i gëzonin të gjithë, ngase ato shkeleshin në mënyra të ndryshme. Vet fjala demokraci ka kuptimin e jo vetëm të trajtuarit në mënyrë të barabartë të njerëzve, por edhe të gjitha të drejtat që i kemi në jetën e përditshme, duhet të jenë të barabarta.

Një ndër proceset më demokratike në një shtet demokratik, pa dyshim është edhe procesi zgjedhor. Me anë të këtij procesi, populli i zgjedh përfaqësuesit (deputetët). Ata e kanë për detyrë të flasin në emër të të gjithë popullit dhe t'i përfaqësojnë interesat e popullit në Kuvend. Zgjedhjet bëhen përmes votave dhe të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare, kanë përgjegjësi të japin votat e tyre në bazë të interesave që kanë. Domethënë, ne zgjedhim deputetët, ndërsa ata zgjedhin Qeverinë dhe Presidentin që do ta udhëheqë vendin për 5 vjet. Në Republikën e Kosovës kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale (komunale) dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare). Në zgjedhjet lokale populli zgjedh kryetarët e komunave përkatëse dhe asambleistët. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore populli zgjedh deputetët. Kryetari i komunës merret me çështje të rëndësishme të qytetarëve të asaj komune, si për shembull: për ndriçimin e rrugëve, për ndërtimin e ndonjë shkolle të re, etj. Ndërsa, deputetët merren



Voto dhe ndrysho të ardhmen tënde

me çështjet më të mëdha shtetërore. Prandaj, kërkohet prej qytetarëve të jenë pjesë aktive, sidomos në procesin zgjedhor, sepse me anë të një vote mund të bëhen ndryshime të mëdha në qeverisjen e vendit. Nëse dëshironi të jeni pjesë e këtyre ndryshimeve voto dhe zgjedh. Duaje më të mirën për vendin tënd dhe kontribuoj sa më shumë në zhvillimin e tij.



Votuesit e së ardhmes



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale
shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:

Tel: +381 38 704 560

E-mail: info@demos-ti.org

Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:

SHFMU „Gafurr Luma“

Klasa: VIII-1 & VIII-2

Vendi: Gllloboçicë, Kaçanik